



# BULIZMI

RAPORT ANALITIK I ALO 116  
Janar-Qershor 2013

# Hyrje



Një ndër problemet më shqetësuese të këtyre kohërave është i ashtëquajtur "bulizëm". Bulizmi është një fenomen jo i vonë për shoqërinë tonë, por që kohët e fundit po merr formën e tij më perfekte dhe zhvillim shqetësues. Gjithsesi koncepti i tij është ende i huaj për ne. Ndaj natyrshëm lind pyetja: Çfarë është bulizmi?

Bulizmi është përdorimi i forcës apo abuzimi që praktikon një grup i shoqërisë për të frikësuar një target grup të caktuar. Ekzistojnë mënyra

të ndryshme për shfaqjen e këtij fenomeni, si dhuna fizike apo psikologjike. Arsyet që bulizmi ekziston si fenomen janë nga më të shumtat por padyshim që edukimi dhe paragykimimi qëndrojnë në krye të listës. Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë, ALO 116/CRCA ka në fokus mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve edhe në rastet kur janë pikërisht vet fëmijët ata që janë shkaktarë të këtyre "shkeljeve" ndaj fëmijëve të tjerë. Nëpërmjet ALO 116 fëmijët kanë mundësi që të raportojnë shqetësimet e tyre të përditshme. Nga këto raportime fëmijët tregojë historitë e tyre të viktimizimit ndaj fenomenit bullizëm. Nisur nga këto histori dhe nga shpeshtësia e paraqitjes së tyre ALO 116 ka zgjedhur **Bulizmin** si tematikë specifike për të trajtuar në këtë raport.

Më gjerësisht në këtë raport do të gjeni: Cili është kuptimi i termit **Bulizëm**, ngacmues/bullies, cilat janë shenjat dalluese që një fëmijë është viktimë e bulling, Cyberbullying, bulizmi me baza

homofobike, historiku i një rasti bulizmi, çfarë këshillon ALO 116, gjithashtu dhe raportimin e telefonatave të mbërritura në linjë përgjatë gjashtë mujorit Janar – Qershor 2013.



## Kush është ALO 116

- Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë, është një shërbim telefonik kombëtar falas, që ka për qëllim të ndihmojë fëmijët kudo në Shqipëri përmes: këshillimit nëpërmjet telefonit, dhënies së informacionit dhe referimit të rasteve tek institucionet qeveritare dhe joqeveritare, që ofrojnë shërbime për fëmijët.

Shërbimi operon 24 orë në ditë, në shtatë ditë të javës. Telefonatat janë konfidenciale dhe priten me profesionalizëm nga psikologë dhe punonjës socialë të kualifikuar. ALO 116 mbështetet nga zyra UNICEF-Shqipëri dhe Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA Shqipëri). Shërbimi bëhet i mundur falas përmes mbështetjes së kompanive celulare AMC, Vodafone, Eagle Mobile dhe operatorit fiks ALBtelecom.

### DEKLARATA E MISIONIT

**ALO 116 - Linja Kombëtare e Telefonit të Ndihmës për Fëmijët** është një shërbim publik kombëtar këshillimi dhe referimi për fëmijët në Shqipëri. Ajo komunikon me fëmijët nëpërmjet numrave: 116 – Linja e Ndihmës për Fëmijët në Shqipëri; 116-000 Linja e Telefonit për Fëmijët e Humbur dhe 116-111 Linja Pan-Europiane e Telefonit për Fëmijët.

ALO 116 flet me fëmijët në momentet më të vështira të jetës së tyre. Ne punojmë që të mbrojmë mirëqenien e fëmijës, nëpërmjet këshillimit me telefon, referimit dhe mbrojtjes pro-aktive të të drejtave të fëmijëve. Parimet kryesore të punës sonë janë:

- ✓ Ne i përgjigjemi falas çdo telefonate të fëmijëve, 24 orë në ditë në 7 ditë të javës;
- ✓ Ne këshillojmë dhe informojmë fëmijët për çdo problem që ata kanë;
- ✓ Ne i shërbejmë të gjithë fëmijëve;
- ✓ Ne referojmë çdo rast, që kërkon zgjidhje, pranë shërbimeve publike dhe private të mbrojtjes së fëmijës;
- ✓ Ne luftojmë për të garantuar në punën tonë standardet më të larta dhe më profesionale të ofrimit të shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë;
- ✓ Ne besojmë se çdo fëmijë dhe i ri, pavarësisht moshës apo aftësisë, gëzon të drejta të barabarta dhe ai është i aftë të identifikojë dhe shprehet për problemet që e shqetësojnë;
- ✓ Ne punojmë që të bëjmë të mundur pjesmarrjen e fëmijëve.

## 1. Fenomeni i bulizmi në botë dhe në Shqipëri.

Bulizmi është një fenomen jo i vonë për shoqërinë tonë, por që kohët e fundit po merr formën e tij më perfekte dhe zhvillim shqetësues. Gjithsesi koncepti i tij është ende i huaj për ne. Ndaj natyrshëm lind pyetja: Çfarë është bulizmi? Bulizmi, ose i shqipëruar “ngacmimi”, është përdorimi i forcës apo abuzimi që praktikon një grup i shoqërisë për të frikësuar një target grup te caktuar. Ekzistojnë mënyra të ndryshme për shfaqjen e këtij fenomeni, si dhuna fizike apo psikologjike. Arsyet që ekzistojnë si fenomen janë nga më të shumtat por padyshim që edukimi dhe paragjykimi qëndrojnë në krye të listës. Përpos mënyrave dhe arsyeve, ajo çka vërtetë kërkon diskutim është zgjidhja e këtij problemi.

Marrëdhëniet që individët krijojnë midis tyre, shpesh mes të rinjëve dhe sidomos adoleshentëve degradojnë. Duke qenë se këta të fundit përjetojnë çdo moment ndryshime, edhe karakteri apo gjendja e tyre emocionale është gjithnjë në ndryshim. Për ta nuk ka nevojë për një shkak specifik për të nisur ashtu papritur një konflikt që më vonë mund të degjenerojë në sherr. Vërehet gjithnjë e më shumë një hije paragjykimi që i karakterizon. Ata nisin të bëjnë diferencën midis njëri tjetrit dhe pa menduar shumë vendosin për bashkëmoshatarët e tyre damkën “të papranuar”. Pikërisht këta të papranuarit janë viktimat e bulizmit, ku çdo moment gjenden nën presionin e dhunës psikologjike. Por përveç ofendimeve dhe veçimit nga grupi, ndodh që të përdoret dhe dhunë fizike. Shkaqet janë nga më sporadiket. Nuk ju pëlqen modeli i flokëve, muzika që dëgjojnë, rryma ideologjike që ndjek, veshjet që përdor, mënyra sesi shprehen etj. Ky është gjithë problemi i bulizmit, pranimi i tjetrit! Çdo i ri duhet të kuptojë se liria e tij shkon deri atje ku nuk çenohet liria e tjetrit.

## 2 - Pse bullying është një çështje e rëndësishme?

Çdo ditë fëmijë të ndryshëm telefonojnë pranë ALO 116 duke treguar frikën e tyre për të dalë nga shtëpia. Ngacmimi është një problem që prek miliona fëmijë. Megjithëse prindërit, mësuesit, dhe të rriturit e tjerë nuk e shohin gjithmonë atë, ata nuk mund të kuptojnë se si ngacmimi mund të marrë përmasa ekstreme.

Dy nga arsyet kryesore se përse fëmijë të ndryshëm janë viktimat e dhunës janë ,për shkak të paraqitjes dhe statusit social. Bulizmi ndodh me ata fëmijë të cilët ngacmuesit mendojnë se nuk përshtaten në shoqëri, ndoshta për shkak të asaj se si ata i shikojnë këta fëmijë, se si ata veprojnë (për shembull, fëmijët që janë të trembur dhe të tërhequr), për shkak të racës apo fesë, ose për shkak se bullies mendon se objektivi i tyre mund të jetë homoseksual.

Disa ngacmues sulmojnë objektivat e tyre fizikisht, apo edhe në formën e një sulmi seksual. Të tjerët e përdorin presionin psikologjik apo fyerjet verbale për të vënë veten në krye, ose përhapin thashetheme mbi viktimën.

Më poshtë kemi disa statistika më të fundit mbi fenomenin e bulizmit të zhvilluara në vitin 2012 nga Byroja e Statistikave të Drejtësisë, Departamenti Amerikan i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore, në 5 shtete të Amerikës si: California, Weë York, Illinois, Pennsylvania, Washington.

- Fëmijëve që raportojnë se kanë qënë viktime të bulling gjatë kohës që kanë qënë në shkollë - 37%
- Fëmijë që ngacmojnë të tjerët dhe që janë shkaktarë të bulling - 17 %
- Fëmijë që bëjnë shaka me fenomenin e bullingut - 20%
- Fëmijë që kërcënojnë nëpërmjet thashethemeve - 10%
- Bulling psikologjik - 20%
- Kërcënime - 6%
- Fëmijë që kanë qënë të përjashtuar nga aktivitetet të ndryshme mes moshatarëve - 5%
- Përqindja e bulling të ndodhur brenda mureve të shkollës - 85%
- Përqindja e ngacmimeve të ndodhura brenda oborrit të shkollës, në autobus ose gjatë rrugës për në shtëpi – 11 %
- Përqindja e shkollave të mesme që kanë raportuar probleme me bulizmin - 44%
- Shkollat fillore që raportojnë probleme me bulizmin - 20%
- Përqindja e nxënësve që shmangin shkollën apo vende të caktuara, sepse janë të frikësuar nga dëmtimet apo lëndimet - 7%
- Përqindja e lëndimeve me armëve në ambjentet e shkollës - 8%

### Statistika për cyberbulling


- Përqindja e nxënësve të cilët kanë raportuar se janë viktime të ngacmimeve kibernetike - 52%
- Adoleshentë të cilët kanë përjetuar cyberbulling - 33%
- Adoleshentë të cilët janë keqtrajtuar në mënyrë të përsëritur nga telefonat e tyre celularë apo internet - 25%
- Adoleshentë të cilët nuk u tregojnë prindërve të tyre kur u ka ndodhur cyber- bullying - 52%

### 3. Kush janë këta ngacmues/bullies dhe si fëmijët referojnë pranë ALO 116

Si djemtë dhe vajzat mund të jenë shkaktarë të bulizmit. Pranë ALO 116 raportohet kjo problematikë nga të dyja gjinitë, por trajtat që ky fenomen merr janë të ndryshme për secilën gjini. Shumë abuzues ndajnë disa karakteristika të përbashkëta si psh tendenca për të dominuar të tjerët dhe fokusimi në përgjithësi në veten e tyre. Ata shpesh kanë aftësi të dobëta sociale dhe gjykim të dobët social. Ndonjëherë ata nuk kanë ndjenja ndjeshmërie ose kujdesi ndaj njerëzve të tjerëve. Ata kanë tendencën të ulin njerëzit e tjerë për të bërë veten të ndjehen më interesant apo të fuqishëm. Disa “abuzues” në fakt kanë çrregullime të personalitetit të cilat nuk lejojnë që ata të kuptojnë emocionet normale shoqërore, si ndjenjën e fajit, dhembshuri apo keqardhje.


Këta fëmijë kanë nevojë për ndihmë nga një profesionist i shëndetit mendor si; një këshillues, punonjës social, psikiatër, apo psikolog. Në bazë të raportimeve të kryera nga fëmijët pranë ALO 116 gjatë katër viteve 2009-2012 mbi rastet e bulizmit, diskriminimit, marrëdhëniet me njeri-tjetrin , paragjykimin kemi këtë tabelë ilustruese si më poshtë:

### TE DHENAT E KRAHASUARA NDER VITE




Tabelat më poshtë pasqyrojnë shpërndarjen e telefonatave sipas gjinisë dhe problematikës ndër vite :


#### 1 - PARAGJYKIMI



## 2 - DISKRIMINIMI



## 3- PROBLEME ME SHOKET



#### 4- BULIZMI





Tabela më poshtë pasqyron shpërndarjen sipas qyteteve :

	Probleme me shoket	Paragjykim	Bulizem	Diskriminim
Berat	76	2	13	
Bulqize	15		3	1
Durres	311	6	29	4
Elbasan	101	5	12	4
Fier	342	3	17	2
Kavaje	98	1	9	2
Lushnje	98	2	10	2
Kruje	43		7	
Tepelene	15			1
Shkoder	52	3	16	1
Kukes	2			
Pogradec	69		7	1
Sarande	53	2	10	
Puke	30		6	2
Tropoje	35		8	1
Vlore	226	2	9	3
Gjirokaster	56		13	
Korce	210	3	17	3
Tirane	712	10	50	7





## 5. Çfarë shenjash dalluese ka fëmija që është viktimë e bulizmit!

Duke iu referuar rasteve të trajtuara nga ALO 116 bulizmi mbetet një nga eksperiencat më të dhimbshme. Shumica e njerëzve mund të kenë përjetuar ndonjë episod të ngacmimit, por edhe mund ta kenë anashkaluar atë qoftë edhe duke ndërruar rrugë. Megjithatë, kur ajo shkon edhe më tej, ngacmimi mund të vendos fëmijën në një gjendje të frikës konstante.

Djem dhe vajza të cilët janë keqtrajtuar mund të shfaqin edhe vuajtje shëndetësore si për shembull: dhimbje stomaku dhe diarre, problem me tretjen etj. Studimet tregojnë se njerëzit të cilët janë abuzuar nga shokët e tyre kanë predispozitën për të shfaqur probleme të shëndetit mendor, të tilla si vetë-vlerësim i ulët, stresi, depresioni ose ankth. Ata gjithashtu mund të mendojnë shpesh për vetëvrasje.

### *Shenja të viktimizimit*

ALO 116 vazhdimisht këshillon prindërit dhe stafin i shkollës, të cilët duhet të jenë të vetëdijshëm mbi shenjat e zakonshme të viktimizimit, duke marrë parasysh se një pjesë e madhe e fëmijëve dhe të rinjve mund të mos kenë besim që të tregojnë incidentet e dhunës për shkak të ndjenjave të mosbesimit dhe mungesës së konfidences tek të rriturit, të cilit fëmija do ti mirëbesojë në zgjidhjen e situates.

Fëmijët ose të rinjtë, të cilët janë viktimë mund të përjetojnë simptoma të tilla si depresioni, shenja ankthi, shqetësimet mbi sigurinë, trishtim, agresioni, rezultate jo të mira në mësim, vetëvlerësim të ulët, defiçite në marrëdhëniet shoqërore dhe përdorim të substancave.

Të rriturit duhet të jenë të kujdesshëm mbi shenjat dalluese të viktimizimit në ambjentet e shkollës të tilla si:

\*Sendet e shumta të humbura

\*Lëndimet e shpeshta apo dëmtimet mbi rrobat apo pronën

\*Kalimi i kohës kryesisht me nxënësit më të vegjël (mund të tregojë një problem me moshatarët)

\*Shmangia e pushimit para, gjatë dhe / ose pas shkollës

\*Arritja në shkollë vazhdimisht me vonesë ose atëherë kur mësimi ka filluar

\*Qëndrimi vetëm shumicën e kohës në shkollë

\*Përgjumje apo të pamjaftueshmëri të gjumit

\*Shqetësime shëndetësore (dmth, dhimbje koke, dhimbje stomaku, etj)

Edhe pse disa nga pikat e lartpërmendura zbatohen vetëm për viktimizimin e drejtpërdrejtë shumica e pikave përfshijnë edhe të rinjtë të cilët kanë qenë të viktimizuar tërthorazi apo dëshmitar i viktimizimit të moshatarëve të tyre.

## **6. Bulizmi dhe internet /Cyberbullying.**

Fëmijët raportojnë pranë ALO 116 forma të ndryshme të Cyberbullying sic janë :

- Thirrjet e telefonisë celulare
- Mesazhet me shkrim
- Foto / video klipe
- E-maile
- Mesazhe në celular
- Dhomat e chatit
- Bixhozi ose lojrat në internet

### **➤ Çfarë lidhje ka ngacmimi në shkollë me cyberbullying?**

Fëmijët raportojnë pranë ALO 116 se Cyberbullying është një çështje e tërë shkollës dhe komunitetit. Ngacmimi në shkollë, në shtëpi, në lagjen, dhe online janë të lidhura të gjitha. Shkollat dhe komunitetet mund të punojnë në unitet për të reduktuar kërcënimin e cyberbullying në mesin e fëmijëve dhe të rinjve.

Ngacmimi është në lidhje me ushtrimin e pushtetit. Kur ne mendojmë për ngacmimin, ne zakonisht mendojmë fuqinë fizike. Megjithatë, pushteti mund të marrë dyja format offline dhe online. Përdorimin e mesazheve, e-mail ose tekste që kërcënojnë, të vënit në siklet, përhapja e thashethemeve apo zbulimi i sekreteve, të gjitha këto janë komponentët e cyberbullying.

Fëmijët të cilët janë pjesë e ngacmimit "offline" kanë më shumë gjasa të jenë të përfshirë në cyberbullying. Fëmijët të cilët ngacmohen ballë-për-ballë mund të jenë edhe viktimë të cyberbullying .

Cyberbullying dallohet nga ngacmimi ballë për ballë në katër mënyra:

- Fëmijët të cilët janë viktimë, nuk kanë vend për të fshehur, dhe mund të jenë në shënjestër në çdo kohë dhe kudo.
- Cyberbullying mund të përfshijë një audiencë shumë të gjerë (p.sh. nëpërmjet qarkullimit të materialeve video në internet).
- Fëmijët që cyberbullying të tjerët janë relativisht të mbrojtur nga anonimiteti i formave elektronike të kontaktit, të cilat mund ta ruajnë atë nga dënimi apo hakmarrja.
- Fëmijët të cilët cyberbullying zakonisht nuk e shohin reagimin e viktimës, duke ndryshuar natyrën e kënaqësisë të gjeneruar normalisht nga bulizmi i drejtpërdrejt.

#### Cilat janë shenjat se fëmija është duke u keqtrajtuar online?

Edhe pse cyberbullying ka potencialin të jetë një formë shumë publike e viktimizimit, në varësi të mundësive të llojit të mediave të përdorura, shumë viktimë të cyberbullying kanë të ngjarë të vuajnë në heshtje.

Shenjat paralajmëruese se dikush mund të jetë viktimë e cyberbullying përfshijnë:

\*Shmangia e kompjuterit, telefonin celular, dhe pajisje të tjera teknologjike ose shfaqja e shenjave të stresit menjëherë sapo merr një e-mail ose tekst.

\*Hezitimi që të shkojnë në shkollë apo të marrin pjesë në ngjarjet shoqërore ose familjare.

\*Shmangia bisedat rreth kompjuterit.

\*Shfaq ndjenja të shumta negative, duke përfshirë, trishtim zemërimi, frustrimi, shqetësim.

\*Notat kanë filluar të bjenë.

\*Mungesa oreksi apo gjumi

## Si mund të parandalohet cyberbullying në ambientet e shtëpisë?

**ALO 116** këshillon prindërit

- \*Mbani kompjuterin tuaj në shtëpi në vende ku mund të shikohet lehtë, të tilla si psh kuzhina;
- \*Bisedoni rregullisht me fëmijën tuaj në lidhje me aktivitetet online që ai ose ajo është i përfshirë;
- \*Flisni në mënyrë specifike në lidhje me cyberbullying dhe nxiteni fëmijën tuaj t'ju tregojë menjëherë nëse ai ose ajo është viktimë e cyberbullying, cyberstalking, apo të tjera sjellje të mundimshme on-line;
- \*Inkurajoni fëmijën tuaj t'ju tregojnë nëse ai ose ajo është në dijeni të të tjerëve të cilët mund të jenë viktimë të një sjellje të tillë;
- \*Shpjegoni se cyberbullying është sjellje e dëmshme dhe e papranueshme. Bëji të qartë fëmijës që nuk do të ketë pasoja për sjellje të papërshtatshme që ai mund të ketë kryer;
- \*Edhe pse të rriturit duhet të respektojnë privatësinë e fëmijëve dhe të rinjve, shqetësimet për sigurinë e fëmijës tuaj ndonjëherë mund të shkelin privatësinë. Tregoni fëmijës tuaj që ju mund të kontrolloni komunikimet on-line në qoftë se ju mendoni se ka arsye për shqetësim;
- \*Konsideroni instalimin e softwerve për filtrim dhe kontrollin e faqeve apo webeve që ai ose ajo përdor;

## 7. Sa i zakonshëm është ngacmimi dhe bulizmi mbi bazë homofobinë?

Ndonëse në Shqipëri ka patur progres të ndjeshëm gjatë viteve të fundit në raport me rritjen e sensibilizimit mbi të drejtat e komunitetit LGBT, realiteti kulturor, tradita patriarkale dhe paragjykimet bëjnë që shumë të rinj LGBT ose të perceptuar si të tillë të bëhen viktimë të një bulizmi të vazhdueshëm nga bashkëmoshatarët e tyre, mësuesit apo edhe të afërmit. Pranë Alo 116 një pjesë e rasteve të raportuara të bulizmit kanë pasur pikërisht bazë homofobinë.

*“Që në shkollën fillore kam vuajtur bulizmin, sidomos nga djemtë. Cdo ditë shkoja në shkollë me frikën se djemtë do më ngacmonin, do më thërrisnin pederast, froço etj. Më shumë kam vuajtur nga mësuesja e anglishtes e cila më fliste me kunja ditën kur Klodi i Big Brother u deklarua. Një ditë, një grup prej rreth 15 djemsh, më rrahën duke më bërë lojën e shkrepses më të shkurtër. Një ditë më hodhën spermën e një djali në floke”. M. Djalë, 20 vjeç, Vlorë.*

Ndërkohë, një studim i realizuar në periudhën Shtator-Nëntor 2011 nga Fondacioni gjerman “Friedrich Ebert” në vend me fokus rininë shqiptare, tregon se 50% e të rinjve, nga të cilët 67% meshkuj dhe 46% femra, nuk do të pranon fqinjësi me një çift homoseksual, duke treguar një nivel të lartë paragjykimi dhe mospranimi ndaj këtij komuniteti. Të rinjë në fshatra janë më paragjykes se sa të rinjtë në qytet, ndërsa femrat rezultojnë të jenë më tolerante ose indiferente nga fqinjësia me një çift homoseksualësh.

### Shenjat për të shikuar për sjellje homofobike përfshijnë:

- Dhuna verbale ose fizike, duke përfshirë dhunën seksuale;
- Komentet nënçmuese, sharjet, fyerjet, shakatë apo kërcënime rreth orientimit seksual ose praktikës seksuale;
- Detyrimi i njerëzve për të zbuluar ose fshehur orientimin e tyre seksual dhe identitetin gjinor;
- Kur lidhet orientimi seksual LGBT me pedofilinë (abuzimin seksual të fëmijës);
- Kur akuzohen persona LGBT për "rekrutimin" e personave të tjerë për t'u bashkuar me orientimin e tyre seksual;
- Njoftime, postera, mesazhe ose grafite homofobike;
- Refuzimi nga miqtë apo anëtarët e familjes për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor;
- Sjellja kur orientimi seksual paraqitet se është vetëm një lidhje seksuale ose një "zgjedhje e mënyrës së të jetuarit";
- Trajtimi i orientimit seksual apo identitetit gjinor të personave LGBT si më pak të vlefshme sesa ato të heteroseksualëve;
- Sjellja sikur të gjithë personat LGBT kanë HIV/AIDS ose janë përgjegjës për përhapjen e saj.

### Këshilla se si të merremi me këtë çështje.

Ashtu si për shumë vështirësi, edhe në këtë rast, nuk ka përgjigje magjike. Për shumë njerëz të rinj, të cilët së pari bëhen të vetëdijshëm se ata janë gay ose lezbike, mund të duan të flasin me dikë, që i dëgjon dhe i pranon ashtu si janë. Nëse personi është në fazën e hershme të marrëdhënies me seksualitetin e tij/saj, ose dëshiron të rrëfejë përvojën e tij për të qenë gei apo lezbike, ajo që ai/ajo do më së shumti është që dikush ta dëgjojë dhe të pranojnë ashtu si është.

Për të rinjtë, të cilët përjetojnë bulizëm dhe/ose ngacmim mbi baza homofobike, është e rëndësishme që të tjerët, sidomos prindërit dhe kujdestarët, të jenë atje për të dëgjuar, për të besuar dhe për të ndihmuar personin që të kuptojë se bulizmi dhe ngacmimi nuk është për faj të tyre. Është e rëndësishme t'i lihet kohë të riut për të shqyrtuar gjendjen, mundësitë dhe ndjenjat e tij për atë që po ndodh.

Të rinjtë duhet të jenë pjesë e planit për të ndaluar bulizimin dhe ngacmimin, duke iu dhënë atyre kohë për të shqyrtuar se si ata do të donin të ndryshonin dhe bëheshin gjërat. Kjo mund t'i ndihmojë ata për t'i menduar gjërat me qartë.

Efektet e bulizimit dhe ngacmimit homofobik mund të jenë shkatërruese dhe shumica e të rinjve do të kërkojnë mbështetjen e prindërve dhe mësuesve. Efektet të tilla si stresi, ulja e aftësisë për t'u përqëndruar, përkeqësimi i rezultateve të shkollës, ankthi, humbja e besimit dhe mungesa e vetë-respektit, nuk mund të injorohen.

Ka një sërë shenjash që mund të paralajmërojnë dikë për faktin se një person i ri është duke u keqtrajtuar. Një humbje e oreksit apo e rregjimit të të ngrënit të zakonshëm, abuzimi me alkoolin ose substancat, sjelljet agresive,

depresioni, sulmet e panikut apo përpjekje për vetvrasje, të gjithë këto mund të jenë shenja që nuk mund dhe nuk duhet të injorohen. Është e rëndësishme të kujtoni që këto shenja mund të tregojnë vështirësitë e tjera që nuk janë të lidhura me bulizimin, kështu që vetëm duke folur me personin, ju do të merrni një pasqyrë të plotë të asaj që po ndodh

## Marrja e mbështetjes

Një person i ri që është viktimë e bulizmit dhe ngacmimit mund të ketë nevojë për mbështetje profesionale apo këshillim, për të nxjerrë jashtë tij/saj ndjenjat negative dhe për të rindërtuar vetë-besimin. Prindërit dhe mësuesit shpesh kanë pyetje se ku mund të marrin mbështetje në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me bulizmin dhe ngacmimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Mbështet të tjera në dispozicion përfshijnë:

- Shërbimi ALO 116 në dispozicion 24 orë në ditë. Telefono në çdo kohë numrin 116, nga celulari juaj ose numri fiks.
- Lexo [www.alo116.al](http://www.alo116.al) për detaje të mbështetjes në dispozicion për të rinjtë.
- Ambasada PINK/LGBT Pro Shqipëri, organizatë e cila punon për të drejtat e komunitetit LGBT në vend. [www.pinkembassy.al](http://www.pinkembassy.al), Email: [info@pinkembassy.al](mailto:info@pinkembassy.al); [communitypink@gmail.com](mailto:communitypink@gmail.com)
- Grup në Facebook: <https://www.facebook.com/groups/pinkembassy>

## 8. Këndi operatorit

Historiku i Rastit

F. jeton në qytetin e Elbasanit dhe frekuenton aktualisht klasën e 9-të. Pasi informohet mbi Linjën e Këshillimit për Fëmijë në mënyrë më të detajuar, shpreh dëshirën për të folur për shqetësimin e tij. F. tregon se në klasën e tij është një bashkëmohatar i cili vazhdimisht e ngacmon duke e ofenduar dhe fyer në prezencë të pjesës tjetër të shokëve të klasës, madje duke arritur edhe në dhunë fizike të shprehur në goditje me shkelma në disa raste. Ka rreth dy javë që ndodh e njëjta situatë në oborrin e shkollës, gjatë pushimeve të mëdha. F. nuk e kupton për çfarë arsye shoku i tij i klasës sillet në këtë mënyrë. Ai nuk ka pasur asnjëherë probleme të tilla më parë. Ka pasur një marrëdhënie disi të largët me të, krahasur me shokët e tjerë të klasës por asnjëherë nuk kanë pasur probleme bashkë. Është përpjekur disa herë të flasë me të për të kuptuar më tepër, por nuk ka marrë asnjë shpjegim prej tij. F. e pëshkruan bashkëmohatarin e vet si një fëmijë që i pëlqen të ndihet superior, një tip të "hedhur", shtatllartë, i cili ka dëshirë gjithmonë ti dëgjohet fjala dhe të jetë në qendër të vëmendjes, ndërsa F. e pëshkruan veten e vet si një fëmijë të rregullt, të urtë dhe që nuk dëshiron të përfshihet në grindje me shokët. Prindërve të vet nuk iu ka treguar asnjë gjë pasi i druhet reagimit të tyre dhe frikës se mos shkakton probleme apo diskutime midis familjesh. Ndërkohë mësuesja e tij kujdestare gjithashtu nuk është në djeni të situatës.

## Trajtimi i Rastit

Fillimisht u bë prezantimi dhe u ndërtua një marrëdhënie midis fëmijës telefonues dhe operatorit këshillues. Fëmija minutat e para të bisedës, u informua mbi shërbimin e Alo 116 pasi e kishte të nevojshme të kishte informacion më të detajuar. Këshilluesja e mirëpriti telefonatën e djalit, duke ofruar ngrohtësi dhe konfidencialitet. Duke realizuar pyetjet e nevojshme, u eksplorua ngjarja dhe situata ku ndodhej.

Gjatë bisedës me fëmijën lidhur me shqetësimin e tij në përgjithësi, u arrit gradualisht që biseda të ngushtohet deri te dhënia e informacioneve të detajuara. Këshilluesja vleroi nivelin e rrezikut në të cilën ndodhet fëmija, formën e abuzimit që bashkëmohatari i tij ushtron ndaj djalit, nëse ka shënja në trup, situatat kur dhe ku ndodh, mendimin e tij lidhur me sjelljen e djalit abuzues etj. Krahas kësaj u eksploruan ndienjat dhe përjetimet emocionale të fëmijës duke treguar empati dhe vëmendje ndaj çdo reagimi emocional, prsh ton zëri, rrjedhshmëria në të folur, qartësia, qetësia, etj reagime të cilat u shfaqën gjatë fokusimit tek ndjenjat dhe emocionet.

Pasi u realizua vlersimi i situatës, ndienjave, marrëdhënieve, duke qënë se fëmija gjatë gjithë kohës mendohej të gjente një shpjegim të llogjikshëm për origjinën e ngacmimeve dhe përpiquej ta gjente shkakun tek vejta, atëhere u pa e arsyeshme që fëmijës ti shpjegohej efekti bullying dhe karakteristikat që ky fenomen ka. Kështu fëmija kishte një panoramë më të gjërë të situatës. Më pas bashkarisht diskutuam mbi alternativa të mundshme që mund ta lehtësonin dhe u eksploruan ndjesitë e fëmijës në secilin rast. Këshilluesja punoi me pjesën e vetëvlersimit dhe ndjenjës së fajit tek fëmija.

Me fëmijën ndërtuam disa mekanizma mbrojtjeje apo shmangieje ndaj ngacmimeve të bashkëmohatarit të tij. Këshilluesja i kushtoi shumë rëndësi edhe komunikimit dhe ndarjes së problemit me personat tek të cilat fëmija ka besim. Mbështetet komunikimi i hapur me familjarët dhe me mësuesen kujdestare duke i dhënë kështu mundësi vetes të kërkojë ndihmë tek persona te të cilët ka besim dhe që mendon se mund ta ndihmojnë. Në fund të telefonatës këshilluesja e falenderoi që fëmija telefoni tek Linja e Këshillimit për fëmije. Ftohet të telefonojë serisht tek ALO 116.

Operatori këshillues: Marsida Haxhi

## 9. ALO 116 këshillon fëmijët!

Disa këshilla se çmund të bëni ju për të luftuar ngacmimin psikologjik dhe fizik. Ato janë gjithashtu këshilla të mira për të ndarë me një mik, si një mënyrë për të treguar mbështetjen tuaj:

### **Injoroni bullies(ngacmuesit) dhe vazhdoni rrugën tuaj.**

Kjo nuk është patjetër përgjigje frikacakësh pasi nganjëherë kjo mund të jetë më e vështirë se humbja e durimit tuaj. Ecin dhe mbani kokën tuaj lartë. Duke përdorur këtë lloj të gjuhës së trupit ju dërgoni një mesazh që nuk jeni të pambrojtur.

### **Mos reagoni me zemërimin kur abuzuesi ju ngacmon.**

Kush është ai që nuk do të mërzhitet dhe të mos reagojë nëse dikush e ngacmon? Por kjo është pikërisht përgjigja që ai ose ajo është duke u përpjekur për të marrë. Ngacmuesit duan të dinë se ata kanë kontroll mbi emocionet tuaja. Nëse ju jeni në një situatë ku ju duhet të merreni me ngacmuesin dhe ju nuk mund të ecin tutje me vetëpërmbytje, përdorni humor –kjo mund ti zbraps ata nga të qënurit gati për sulmin e mëtejshëm. Pra punoni me kontrollin e zemërimit tuaj.

### **Mos përdor dhunë fizike.**

Nëse zgjidhni t'i kundërpërgjigjeni ngacmuesit mos përdorni forcë fizike (si shkelmimi, goditja, ose shtytje) pasi ju kurrë nuk mund të jeni i sigurt se çfarë kundërpërgjigje mund të merrni. Përgjigjet agresive kanë tendencë të çojë në më shumë dhunë dhe më shumë ngacmim për viktimat.

### **Praktiko vetbesimin.**

Mundohuni të gjeni teknika që ju bejnë të ndiheni mirë me veten.

### **Marrja e përgjegjësië për veten tuaj.**

Ju nuk mund të kontrolloni veprimet e njerëzve të tjerë, por ju mund të kontrolloni veten. Mendoni për mënyra për t'u ndjerë mirë dhe më të fortë me veten tuaj - në mënyrë që fëmijët e tjerë të mund të heqin dorë nga ngacmimi. Ushtrimi është një mënyrë për t'u ndjerë i fortë dhe i sigurt. Mëso arte matciale ose yoga. Një tjetër mënyrë për të fituar besimin është zhvillimi i aftësive tuaja aty ku ju ndiheni mirë si psh: shah, art, muzikë, kompjutera, shkrim, futboll etj. Bashkimi me një klub, klasë, apo palestër është një mënyrë e mirë për të bërë miq të rinj dhe të ndjehesh besim të madh në vete. Besimi që do keni fituar do t'ju ndihmojë të injoroni fëmijët që mund t'ju ngacmonjë.



# FËMIJËT RAPORTOJNË

## Janar-Qershor 2013

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2013 pranë Alo 116 janë pritur gjithsej nga operatorët këshillues **29.277** telefonata. Ndër to **14.178** telefonata janë kryer nga meshkuj, **6.130** kanë qënë femra dhe **8.969** telefonues nuk e kanë identifikuar gjininë e tyre.

Tematikat kryesore të telefonatave të kryera kanë qënë: marrëdhënia me prindërit, problemet në shkollë, marrëdhënia me bashkëmoshatarët, probleme të duhanpirjes, marrëdhënia me partnerin/it etj. Përveç kësaj ka një numër shumë të lartë të telefonatave testuese, në të cilat bëjnë pjesë telefonatat ofenduese, talljet, vendosja e muzikës, zhurma, ose rastet kur fëmijët zhvillojnë biseda për të testuar këshilluesit ose shërbimin që linja ofron.

Duke u nisur nga të dhënat e mbledhura, në këtë raport ne do të paraqesim një klasifikim të të dhënave cilësore dhe sasiore të telefonatave që kanë ardhur në ALO 116 gjatë gjysmës së parë të vitit 2013.

➤ **Klasifikimi i përgjithshëm i telefonatave**

Tabela e mëposhtme tregon numrin e telefonatave të ndarë sipas kategorive përkatëse :

Tel. sipas Kategorive	Janar-Qershor 2013
Tel. për informacion	7166
Tel. për këshillim	433
Tel. për referim	41
Tel. të ndërprera	3153
Tel. testuese	14626
Heshtje	3839
<b>Totali</b>	<b>29277</b>




Tabela më poshtë tregon shpërndarjen e telefonatave për informacion sipas nën-kategorive përkatëse.

Telefonata për informacion	Nr Fëmijëve
Informacion mbi linjën	1098
Mbi çështje të fëmijëve/të drejtat e fëmijëve	118
Faleminderit për ndihmën	37
Telefonata përshëndetëse	623
E pa specifikuar/të tjera	5170
<b>Totali</b>	<b>7166</b>

Çdo telefonatë që pritet regjistrohet në sistemin e të dhënave sasore dhe cilësore të ANCH. Shifra e mësipërme nuk përfaqëson numrin e fëmijëve që kanë kaluar në fazën e këshillimit, por numrin e telefonatave që kanë marrë përgjigje nga operatorët këshillues.

Tabela më poshtë tregon shpërndarjen e **telefonatave testuese** sipas nënkategorive përkatëse.


Telefonata testuese	Nr. i fëmijëve
Ofendim	466
Sharje	485
Tallje	6404
Kërcënim	8
Zhurme	828
Mbyllje	4736
Muzikë	264
Informacion	20
Abuzim dhe dhunë	0
I larguar nga shtëpia/me nevoja bazë	0
Mardhënia me partnerin	6
Abuzim me substancat	0
Probleme në shkollë	0
Marrëdhënia me familjen	0
Seksualiteti	0
Shëndeti fizik/mendor	0
Diskriminim	0
<b>Totali</b>	<b>14626</b>

Këtu paraqiten në mënyrë të detajuar telefonatat testuese, duke saktësuar mënyrat e shumëllojshme nëpërmjet të cilave fëmijët testojnë linjën. Në nivele të larta paraqitet numri i telefonatave të mbyllura dhe telefonatat tallëse. Gjithashtu, ka një numër të konsiderueshëm fëmijësh që telefonojnë nga mjedise të zhurmshme.

Telefonuesit e rinj të identifikuar që kanë telefonuar gjatë këtij tre mujori janë **14.626**. Ky numër përfaqëson fëmijët dhe të rinjtë të cilët kanë telefonuar për herë të parë në linjë.

Tabela dhe grafiku më poshtë paraqet numrin e *telefonatave periodike* (raste të cilat telefonojnë në linjë në mënyrë periodike), *telefonatave permanente* (telefonues të cilët kanë krijuar varësi dhe telefonojnë në mënyrë të përsëritur dhe të vazhdueshme), *telefonuesve të rinj* (kjo kategori shpreh numrin total të fëmijëve që telefonojnë për herë të parë) dhe *telefonata të paidentifikuara*.

Tel. sipas llojit të tyre	Nr.tel.
Tel. të reja	5882
Tel. periodike	1914
Tel. permanente	2279
Tel. të paidentifikuara	19202
<b>Totali</b>	<b>29277</b>




➤ **Analiza e të dhënave sipas rasteve të raportuara**

Tabela më poshtë tregon problematikat e raportuara nga fëmijët gjatë muajve Janar-Qershor 2013.

Problematikat	Gjinia	Meshkuj	Femra
Abuzim dhe dhunë		14	14
Shfrytëzim për arsye përfitimi		2	4
Fëmijë me nevoja bazë		4	3
HIV-AIDS		0	0
Marrëdhëniet mes njëri-tjetrit		50	137
Probleme në shkollë		17	20
Çështje ligjore		0	2
Përdorim dhe abuzim me substanca		8	4
Fëmijë me aftësi të vecanta		0	3
Seksualiteti		12	4
Marrëdhëniet familjare		23	64
Shëndet mendor/psikosocial		10	25
Shëndet Fizik		1	5
Diskriminimi		1	1
Siguria në internet dhe celular		4	1
<b>Totali</b>		<b>146</b>	<b>287</b>

Në grafikun e mësipërm tregohet një krahasim i të dhënave midis gjinive dhe problematikave që telefonuesit raportojnë në linjë. Nga analizimi i të dhënave del se numri më i madh i telefonatave kryhet nga meshkujt ndërsa janë femrat ato që raportojnë më shumë shqetësime dhe probleme tek këshilluesit.

Siç mund të shihet nga grafiku i mëposhtëm, fëmijët përballen me një gamë të gjerë të çështjeve, shqetësimeve dhe problemeve. Një pjesë e këtyre shqetësimeve është e identifikuar nga ata dhe raportohet menjëherë tek këshilluesit, por në mjaft raste duhet ndihma e këshilluesve, të cilët me profesionalizmin e tyre dëgjojnë problemet e fëmijëve në mënyrë aktive, ndihmojnë në identifikimin e problemeve reale dhe kontribuojnë në përmirësimin e situatës apo problemit të shfaqur.




Më së shumti, shqetësimet e paraqitura nga fëmijët gjatë muajve Janar- Qershor 2013, kanë lidhje me marrëdhëniet mes tyre (marrëdhëniet me fëmijë të tjerë, marrëdhëniet me partnerin, dhe marrëdhëniet afektive), abuzimi me substancat (informacion për substancat e ndryshme dhe varësia nga substancat), marrëdhëniet në familje (marrëdhëniet prind-fëmijë, marrëdhëniet vëllazërore, kujdestaria e fëmijës, mbështetja e fëmijës), problemet në shkollë (probleme të performancës , marrëdhënia me mësuesit apo me personat të tjerë të rritur) etj.

Nga grafiku duket qartë se shqetësimet në lidhjet ndër-personale vazhdojnë të jenë në nivel raportimi të lartë ashtu si dhe problemet në lidhje me anëtarët e familjes.

➤ **Të dhënat e ANCH sipas klasifikimit gjinor**

Gjatë këtyre muajve sic mund ta mund të vemë re dhe ne grafikun më poshtë numri i telefonuesve meshkuj vijon të mbetet më i lartë, krahasuar me numrin e telefonueseve femra.




Moshë \ -Gjinia	-Gjinia			TOTAL
	Djem	Vajza	Gjini e panjohur	
0-6 vjeç	208	218	0	426
7-9 vjeç	446	401	0	847
10-12 vjeç	1711	1258	0	2969
13-15 vjeç	2054	1219	0	3273
16- 17	820	539	0	1359
18 +	1167	523	1	1691
<b>Moshë e panjohur</b>	7772	2062	8968	18802
<b>TOTALI</b>	14178	6130	8969	29277





Më poshtë paraqitet shpërndarja e rasteve të trajtuara në pesë qytetet kryesore, të cilat kanë dhe numrin më të lartë të telefonatave që vijnë në ALO 116.

<i>Kategoritë</i>	<i>Qytetet</i>	<i>Tiranë</i>	<i>Durrës</i>	<i>Shkodër</i>	<i>Elbasan</i>	<i>Korcë</i>
<i>Abuzim dhe dhunë</i>		4	2	4	2	0
<i>Shfrytëzim për arsye përfitimi</i>		0	0	0	0	0
<i>Fëmijë me nevoja bazë</i>		3	3	1	0	0
<i>HIV-AIDS</i>		0	12	0	0	0
<i>Marrëdhëniet mes njëri-tjetrit</i>		37	6	19	6	4
<i>Probleme në shkollë</i>		8	0	4	1	0
<i>Çështje ligjore</i>		0	4	0	0	0
<i>Përdorim dhe abuzim me substanca</i>		0	1	2	0	0
<i>Femijë me aftësi të veçanta</i>		0	0	0	1	0
<i>Seksualiteti</i>		1	4	1	0	0
<i>Marrëdhëniet familjare</i>		11	4	8	0	1
<i>Shëndet mendor/psikosocial</i>		8	0	6	3	0
<i>Shëndet Fizik</i>		2	0	0	0	1
<i>Diskriminimi</i>		0	0	0	0	0
<i>Përdorimi i sigurtë i internetit</i>		1	0	0	0	0

## Tiranë







➤ **Referimi i rasteve në Institucionet shtetërore dhe OJF**

Tabela e mëposhtme tregon shpërndarjen e referimeve në institucionet përkatëse.

Linja e keshillimit per gra dhe vajza	5
Shoqata per gruan me probleme sociale	1
Emisioni Nga e Para , Vizion Plus	2
TLAS, ndihme ligjore falas	2
Kryqi I Kuq, Durres	1
Fondacioni "Femijet Shqiptare"	1
Sherbim Shendetsor	6
Drejtoria Arsimore	5
Bashkia /Komuna e qytetit perkates	8
CPU	1
Avokat 1 Popullit	1
ASHMF, Agjensia shteterore per mbrojtjen e femijeve	1
Sherbimi Psikologjik i Shkolles ku studion	1
Zyra ndihmës ekonomike Tiranë	1
Kryqi Kuq Shqiptar ( dega Gramsh)	1
Sos ( Don Bosko)	1
Insituti Shërbimeve Psikologjike	1
Policia	5




Tabela më sipër pasqyron referimet e kryera nga ALO 116 sipas problematikave specifike të rastit përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit.

### Referenca

1. Flannery, D. J. Wester, K. L., & Singer, M. I. (2004). Impact of exposure to violence in school on child and adolescent mental health and behavior. *Journal of Community Psychology*, 32, 559-573.
2. Fine, M., Freudenberg, N., Payne, Y., Perkins, T., Smith, K., & Wanzer, K. (2003). "Anything Can Happen Ëith Police Around": Urban Youth Evaluate Strategies of Surveillance in Public Places. *Journal of Social Issues*, 59, 1, 141-158.
3. Card, N. A., Isaacs, J., & Hodges, E. V. E. (2007). Correlates of School Victimization: Implications for Prevention and Intervention. In J. E. Zins, M. J. Elias, & C. A. Maher (Eds.), *Bullying, Peer Harassment, and Victimization in the Schools: The Next Generation of Prevention* (pp. 339-356). New York: The Haworth Press, Inc.
- 4 Interneti

## **ALO 116-Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë është një shërbim pa pagesë për fëmijët 24/24 çdo ditë të javës I cili ofron:**

- Dëgjim aktiv të fëmijëve
- Këshillim psikologjik
- Informacion për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve
- Referim në shërbimet përkatëse sipas specifikës së rastit.

Ky shërbim përqëndrohet tek fëmijët në nevojë si: fëmijët e dhunuar, abuzuar apo keqtrajtuar, fëmijët e rrugës, fëmijët që shfrytëzohen në punë, fëmijët që janë në konflikt me ligjin etj. Ky shërbim nuk përjashton as prindërit, mësuesit, edukatorët apo personat që punojnë me fëmijët dhe personat e intersuar për çështje lidhur me dhe për fëmijët.

**ALO 116, si një shërbim kombëtar në ndihmë të fëmijëve, zbatohet nga CRCA Shqipëri-Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve:**



**ALO 116 mbështetet dhe financohet nga:**

